



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

## FTESË

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **X-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024**.

Seanca mbahet **më 29.11.2024 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

## RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë: **25.10.2024**,
3. Pyetje dhe përgjigjeje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së të datës **08.11.2024**,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullorës për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës (ref.drejt.fin.),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shtim të buxhetit për bashkëfinancim me qytetarë për projektin "Furnizim me freza për traktor dhe shpërndarëse plehu" (ref. drejt. bujqësisë),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shtim të buxhetit për bashkëfinancim me qytetarë për projektin "Furnizim me koshere bletësh"
8. Informatë për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Klinës (ref. DSHPE).

01Nr. 06-39232 2024  
Klinë, me 18.11 2024



Kryesuesi i Kuvendit  
**Fadil Gashi**